



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E KULTURËS, ARSIMIT,
RINISË DHE SPORTIT
Nr. 9575 Prot
Shkodër, më 03.06.2019

SHOQATA KULTURORE ARTISTIKE
"JEHONA E SHKODRES"

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

PËR SHFAQJEN E CIRKUT

"ARENË MAGJIKE "

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi lidhet ndërmjet:

Bashkisë Shkodër me seli ligjore Rr. "13 Dhjetori", Shkodër, përfaqësuar nga Znj. Voltana ADEMI në cilësinë e Titullarit të Institucionit,

dhe

Shoqata Kulturore Artistike «Jehona e Shkodres», e regjistruar si person juridik me vendim Gjykate me nr 53, me adresë kryesore: Lagjia "Guerrile", Rruga "Mustafa Dervishi" nr.31, Shkodër dhe me nr. Nipti L57325131L dhe e përfaqësuar ligjërisht nga z. Xhelal Halili , në cilësinë e presidentit të shoqatës.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore"

OBJEKTI:

Bashkëpunim me qëllim zhvillimin e aktiviteteve kulturore në kuadër të promovimit dhe zhvillimit të artit, kulturës, turizmit dhe promovimit të territorit.

Duke qenë se:

Bashkia Shkodër ka prioritet mbështetjen dhe zhvillimin e aktiviteteve kulturore, nëpërmjet:



Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

- ✓ Zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë.
- ✓ Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor.
- ✓ Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar lokal si dhe zhvillimin e artit, kulturës, turizmit dhe promovimit të territorit.

Palët bien dakort sa mëposhtë:

QËLLIMI

Shoqata Kulturore Artistike “Jehona e Shkodres”, ka si qëllim të saj in gjallërimin e jetës kulturore artistike të qytetit të Shkodrës. Ajo zhvillon veprimtari kulturore të ndryshme me qëllim promovimin e traditave të qytetit të Shkodrës si dhe gjallërimin e jetës së qytetit përmes aktiviteteve të ndryshme.

Shoqata Kulturore Artistike “Jehona e Shkodres” do të organizojë shfaqjen e Cirkut me trupen e Tiranës të titulluar “ Arenë Magjike ”, në Pallatin e Sportit “Qazim Dervishi” me datë 14.06.2019 nga ora 18:00 – 20:00.

Realizimi i kësaj shfaqje, ka për qëllim argëtimin e fëmijëve të moshave të ndryshme, të cilët kanë mundësi të shijojnë magjinë e vërtetë të Cirkut.

Eksperienca shumë vjeçare e kësaj shoqate dhe ky aktivitetet në vetvete është garanci e padiskutueshme suksesi.

Shfaqja “Arenë Magjike ” realizohet në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër dhe Pallatin e Sportit “Qazim Dervishi”

AFATI I MARRËVESHJES

Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet nga palët me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë, me afat nga momenti i nënshkrimit të saj deri me datë 30.06.2019.

FORMA E BASHKËPUNIMIT

Realizimi nga ana e Shoqata Kulturore Artistike “Jehona e Shkodres” e shfaqjes “Arenë Magjike” në Pallatin e Sportit “Qazim Dervishi”, Promovimi i aktivitetit në media dhe në

Adresa Rr. 13 Dhjetori, Nr. 3 Shkodër, web: www.bashkeshkodër.gov.al e-mail: info@bashkeshkodër.gov.al



qytet përmes posterave, banerave etj, duke vënë në dukje bashkëpunimin me Bashkinë Shkodër.

Krijimi i kushteve të nevojshme nga ana e administratës së Bashkisë Shkodër dhe Pallatit të Sportit "Qazim Dervishi" për realizimin me sukses të këtij aktiviteti. Promovimi i aktivitetit në rrjetet online të Bashkisë Shkodër.

KOMUNIKIMI

Çdo komunikim midis palëve do të bëhet me shkrim.

ZGJIDHJA E AKT MARRËVESHJES

Asnjëra nga palët nuk ka të drejtë të zgjidhë aktmarrëveshjen në mënyrë të njëanshme pa shkaqe të arsyeshme dhe para se të kenë njoftuar njëra - tjetrën me shkrim.

Palët bien dakort që çdo mosmarrëveshje apo kontraditë do të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim.

Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së aktmarrëveshjes dhe procedurave juridike në fuqi, sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

DISPOZITA TË FUNDIT

Kjo akt marrëveshje do të quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

Kjo aktmarrëveshje u hartua në tre kopje, nga të cilat njërën e merr shoqata kulturore artistike "Jehona e Shkodres", ndërsa dy të tjerat i mban Bashkia Shkodër.

PËR
BASHKINË SHKODËR

KRYETAR


Voltana Ademi

SHOQATA KULTURORE ARTISTIKE
"JEHONA E SHKODRES"
KRYETAR

Xhelal Halili



